



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



22-01-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 204-2021

Në pajtim me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5 dhe 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr.9/2013 për Votim, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit, si dhe nenin 3 germa (a) dhe (b) të Rregullës Zgjedhore 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjet e rregullt të mbajtur me 22.01.2021, nxjerr këtë:

UDHËZUES

Për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për Zgjedhjet Praktikshme për Kuvendin e Kosovës 2021

- I. Udhëzohen Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV) të cilat merren me organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që ditën e zgjedhjeve, me 14 shkurt 2021, t'i pranojnë në vendvotim dokumentet e identifikimit të votuesve, siç janë:
 - a. leternjoftim i vlefshëm i Kosovës;
 - b. pasaport valide;
 - c. dokument i vlefshëm i udhëtimit;
 - d. leje e vozitjes e vlefshme e Kosovës;
- II. Dokument i vlefshëm i votimit konsiderohen të gjitha dokumentet e Republikës së Kosovës, siç i parasheh pika I e këtij Udhëzuesi.
- III. Ky Udhëzues është i obligueshëm për KKZ-të dhe KVV-të, në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës dhe zbatohet në ditën e zgjedhjeve, më 14 shkurt 2021.
- IV. Kontakti për informata shtesë apo sqarime shtesë për votuesit, strukturat menaxhuese të zgjedhjeve lidhur me këtë Udhëzues është :
Nr. Tel : 0800 55 555
- V. Ky Udhëzues hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe iu dërgohet trupave zgjedhore menjëherë.

Prishtinë, 22.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

